



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar njofton përfaqësuesit e medias se, në kuadër të hyrjes në fuqi të Rregullores së Brendshme “*Për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e GJKKO-së*”, si dhe fillimit të procesit të akreditimit të përfaqësuesve të medias, grupi aktual i komunikimit të Gjykatës me mediat në aplikacionin WhatsApp, duke filluar nga data e sotme, nuk do të jetë më aktiv.

Në vijim, Gjykata, do të krijojë një grup të posaçëm komunikimi në aplikacionin WhatsApp, në të cilin do të përfshihen vetëm përfaqësuesit e medias të akredituar pranë GJKKO-së. Nëpërmjet këtij grupi do të vijojë shpërndarja e njoftimeve për çështjet dhe kërkesat penale të shpallura, e deklaratave për shtyp, si dhe e çdo komunikim tjetër me interes për median.

Sqarojmë se të gjitha njoftimet dhe komunikatat që do të shpërndahen në grupin e ri të komunikimit me mediat do të publikohen, në çdo rast, edhe në faqen zyrtare të Gjykatës.

Lidhur me procedurën e akreditimit të përfaqësuesve të medias pranë GJKKO-së, ju informojmë se në faqen zyrtare të Gjykatës, në rubrikën “Multimedia”, në link-un [Akreditimi i përfaqësueve të medias pranë GJKKO-së](#), gjenden:

- Aneksi nr. 7 – “Formular për akreditimin e përfaqësuesve të medias”;
- Aneksi nr. 8 – “Deklaratë e njohjes dhe respektimit të rregullave të sigurisë, rendit dhe sjelljes nga përfaqësuesit e medias”.

Formulari dhe deklaratat e mësipërme duhet të paraqiten së bashku me dokumentet e tjera të përcaktuara në nenin 90 të Rregullores së Brendshme dhe në aneksin nr. 7 të saj.

Kërkesa për akreditim dhe dokumentacioni shoqërues mund të paraqiten:

- dorazi, pranë Zyrës së Protokollit të GJKKO-së;
- nëpërmjet shërbimit postar; ose

- me postë elektronike, në adresën: Elsa.Lita@gjkata.gov.al

Gjkata falënderon përfaqësuesit e medias për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

Tiranë, më datë 01.09.2026

Gjkata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar